**VENDIM**
**Nr. 164, datë 17.3.2021**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. ARBEN HYSKO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 20, datë 20.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**